



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

OLIMPIADA KOMBËTARE E GJEOGRAFISË
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Faza e dytë

Klasa 11

7 shkurt 2026

Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10:00 dhe mbaron në orën 13:00.
- Testi përmban 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë
Pikët e fituara					

Totali i pikëve të fituara

KOMISIONI I VLERËSIMIT


1.....

2.....

1. Vullkanet dallohen nga njëri-tjetri edhe nga mënyra e shpërthimit të tyre.

a) Identifikoni tipin dhe dy nga veçoritë dalluese të vullkaneve me numër 2 dhe 6.

6 pikë



Vullkani me numrin 2:

Vullkani i tipit Islandik. Përfaqëson një nga kategoritë kryesore të aktivitetit vullkanik. Ka shpërthim të tipit efuziv (jo shpërthyes); lava del qetë, ngadalë pa shpërthime të fuqishme pasi lava është bazike dhe ka përqendrim të vogël të gazeve dhe silikateve. Shpërthimet ndodhin gjatë çarjeve të gjata në koren tokësore, në vend të një krateri të vetëm. Ky lloj aktiviteti, siç shihet dhe në figurë, formon fusha të gjera dhe peizazhe të sheshta dhe uniforme

Vullkani me numrin 6:

Vullkan i tipit Strambolian. Ky tip vullkani bën pjesë në grupin e vullkaneve shtresë. Formohen kur magma ka përbërje midis asaj bazike dhe asaj acide. Me shpërthimet të tipit eksploziv, përhapjen e hirit, lapileve alternohen me shpërthimet efuzive me përhapje të llavës, pra shpërthime periodike. Shtresat e llavës së ngurtësuar pasohen me shtresa të hirit vullkanik, lapileve e bombave dhe koni vullkanik është e shtresëzuar.

b) Cili nga dy tipat e vullkaneve të mësipërm shfaq rrezikshmëri më të lartë? Argumentoni përgjigjen tuaj. **1 pikë**

Vullkanet e tipit Strambolian janë më të rrezikshëm për shkak të mënyrës së shpërthimit të tyre, të tipit eksploziv, llojit të llavës dhe produkteve të tjera vullkanike që dalin gjatë shpërthimeve.

c) Gejzerët njihen si fenomene vullkanike dytësore. Shpjegoni se si formohen ato.

3 pikë

Gejzerët përfaqësojnë një shpërthim uji me avuj shumë të nxehtë me ndërprerje dhe vrull që dalin nga të çarat në Tokë. Në gejzer uji nëntokësor mbledhet në zgavrat të nëndheshme ku ngrohet nga temperatura e lartë për shkak të afërsisë me dhomat magmatike. Edhe pse temperaturat janë mbi 100 °C në fund të zgavrave uji nuk zien e nuk kalon në gjendje të gaztë. Kjo për shkak të trysnisë të ushtruar nga pesha e ujit që ndodhet lart. Nëse ndryshon pak pesha (trysnia) si nga derdhja, largimi pak i ujit nga jashtë, uji i mbinxehur në fundin e zgavrës transformohet menjëherë në avull duke dalë me furi me rrjedhje të cilat mund të arrijnë lartësinë prej dhjetëra metrash. Shpërthimet përsëriten me ndërprerje pothuajse të rregullta.

2. Vendi ynë dallohet për një larmi të madhe hidrografike që shfaqet me shumëllojshmëri të objekteve ujore si dete, lumenj, liqene të llojeve të ndryshme, ujëra nëntokësore, etj.

- a) Një nga veçoritë e lumenjve në Shqipëri është dendësia e rrjetit hidrografik, lumor. Shpjegoni se çfarë tregon dendësia e rrjetit hidrografik. **2 pikë**

Dendësia e rrjetit hidrografik është një tregues morfometrik që shpreh shkallën e copëtimit të një territori nga rrjedhat ujore (lumenjtë, përrenjtë dhe degëzimet e tyre. Dendësi tregon se si është raporti i rrjedhjeve ujore në raport me sipërfaqen në një rajon të caktuar. Ai shprehet km/km^2)

- b) Shpjegoni pse në pellgjet ujëmbledhëse të Shkumbinit, Semanit dhe Matit dendësia e rrjetit hidrografik është e madhe. **2 pikë**

Kjo sepse këto pellgje përbëhen kryesisht nga shkëmbinj terrigjenë e magmatikë, kanë një reliev të thyer, reshje të shumta dhe bimësi përgjithësisht të varfër)

- c) Pse është e rëndësishme të studiohet dendësia e rrjetit hidrografik? **2 pikë**

Një dendësi e lartë tregon se zona është e rrezikuar nga erozioni dhe përmytjet e shpejta. Studimi na ndihmon të kuptojmë se sa ujë mund të grumbullohet në një zonë për qëllime vaditjeje apo energjetike.)

- d) Për Shqipërinë është karakteristike dhe koeficienti shumë i madh i rrjedhjes. Analizoni faktorët që ndikojnë në vlerat e larta të koeficientit të rrjedhjes së lumenjve. **3 pikë**

Faktorët klimatike me përqëndrimin e reshjeve kryesisht gjatë gjysmës së ftohtë të vitit, ku avullimi është minimal dhe me intensitetin e reshje; faktorët litologjikë që lidhet me shtrirjen e madhe të formacioneve të përshkueshme dhe dalja në shumë raste e formacioneve rrënjësore në sipërfaqe; faktorët topografikë që lidhet me mbizotërimin e shpatit me pjerrësi të konsiderueshme; faktorët bimorë ku shumë territore janë të zhveshura e pa bimësi)

- e) Lumenjtë e vendit tonë dallohen dhe për regjimin e tyre torrencial. Çfarë kuptoni me regjim torrencial të lumenjve në vendin tonë? **1 pikë**

Kjo do të thotë që lumenjtë e vendit tonë dallohen për luhatje të mëdha të prurjeve, dhe për fryrje të menjëhershme të niveleve të tyre gjatë shirave të gjatë e intensivë dhe uljen e shpejtë të këtyre niveleve.

3. Shqipëria që nga viti 1989 e deri në censin e vitit 2023 po përballet me ulje të ndjeshme të popullsisë, që sipas INSTAT, është 780, 000 banorë ose 24.5% e popullsisë, ulje që i dedikohet kryesisht emigracionit të jashtëm të popullsisë.

- a) Shpjegoni se si ka ndikuar emigracioni i jashtëm në ndryshimin e strukturës së popullsisë në Shqipëri. **4 pikë**

Në emigracionin e jashtëm janë përfshirë kryesisht mosha e reja të popullsisë duke ndikuar kështu në ndryshimin e **strukturës moshore** ku në Censin e vitit 2011 grupmosha e tretë, (grupmosha + 64 vjeç) u rrit në 11.3 % nga 7.5% në vitin 2001, dhe në vitin 2023 kjo shifër u rrit akoma më shumë në 19.7% të popullsisë që zinte kjo grupmoshë.

Emigracioni i jashtëm ndikoi dhe në ndryshimin e **strukturës gjinore** të popullsisë pasi fillimisht më të prirur drejt emigracionit ishin meshkujt se femrat ku në vitin 2001 për herë të parë femrat zinin 52% përkundrajt 48% meshkuj, por që u ndryshua në vitin 2011, me 51% meshkuj dhe 49% femra pasi në dekadat e fundit në emigracionin e jashtëm u përfshinë edhe femrat. Kjo shifër u përmbys sërish në Censin e 2023 pasi 50,5% janë femra e 49,5% janë meshkuj.

- b) Vlerësoni rolin e emigracionit të jashtëm në procesin e plakjes së popullsisë në Shqipëri dhe ndikimin e tij në perspektivën demografike afatgjatë të vendit. **3 pikë**

Më të prirur të largohet jashtë është grupmosha e re e popullsisë e cila është e aftë për riprodhim dhe shtim të popullsisë. Kjo ka bërë që në Shqipëri të ulet ndjeshëm numri i lindjeve dhe gjithashtu të rritet dhe mosha mesatare e popullsisë nga 35.3 vjeç në vitin 2011 në 42. 5 vjeç në vitin 2023, tregues ky për plakjen e popullsisë.

Plakja e popullsisë do shoqërohet me një sërë pasojash si tkurrje e numrit të përgjithshëm të popullsisë, rritjen e grupmoshës së tretë, sfida ekonomike pasi ulet fuqia punëtore dhe rritet përqindja e popullsisë që trajtohet me sigurimet shoqërore etj.

- c) Analizoni pasojat ekonomike dhe sociale që ka sjellë migrimi i brendshëm i popullsisë në Shqipërinë, duke u fokusuar në tregun e punës dhe në zonat rurale të rajoneve periferike. **3 pikë**

Pasojat ekonomike të lëvizjeve migratore në Shqipëri janë të shumta pasi ndikojnë në uljen e fuqisë punëtore për rajonet që largohen sidomos në sektorin e ekonomisë bujqësore dhe degëve tradicionale të ekonomisë, (industria e drurit, nxjerrja e mineraleve, artizanati).

Nga ana sociale, zonat rurale periferike, (kryesisht rajoni Verior- Verilindor dhe rajoni Jugor), janë përballur me braktisje, plakje të popullsisë dhe dobësim të shërbimeve bazë, si arsimi dhe shëndetësia, duke thelluar pabarazitë rajonale dhe duke vështirësuar zhvillimin e qëndrueshëm territorial.

4. Shkruani një ese argumentuese me temë: “Zhvillimi i Rajonit Verior dhe Verilindor, sfida dhe alternativa për një zhvillim të qëndrueshëm”.

10 pikë

Eseja do të vlerësohet për këto aspekte:

Fokusi i esesë:

- Ekonomia bujqësore dhe zhvillimi rural.
- Turizmi malor dhe ekologjik.
- Energjia e rinovueshme.
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe lidhjeve rajonale.

Hyrja / prezantimi – 2 pikë

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit. Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.

5. Shkruani një ese argumentuese me temë: “Pozita gjeografike e Shqipërisë dhe rëndësia e saj në integrimin në Bashkimin Evropian”. **10 pikë**

Eseja do të vlerësohet për këto aspekte:

Fokusi i esesë:

- Analiza e pozitës gjeografike.
- Avantazhet strategjike në politikë dhe ekonomi.
- Mundësi për investime të huaja.
- Bashkëpunim racional dhe ndërkombëtar.

Hyrja / prezantimi – 2 pikë

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit. Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.